

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2023**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2023

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar në mungesën e likuiditetit në sistemin bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹.) Burimi: Banka e Shqipërisë.

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj	REPO Njëditore	Totali i likuiditetit të injektuar
5-tetor-23		23.96			43.65
12-tetor-23		33.53			53.22
19-tetor-23		43.64			63.33
24-tetor-23			8.10		63.35
26-tetor-23		42.73			62.44
2-nëntor-23		23.03			42.73
9-nëntor-23		21.20			40.91
16-nëntor-23		22.65			42.36
23-nëntor-23		22.97			42.68
24-nëntor-23			4.30		42.68
30-nëntor-23		28.08			47.70
7-dhjetor -23		19.80			39.41
14-dhjetor -23		23.32			42.94
21-dhjetor -23		29.36			48.97
24-dhjetor -23			2.66		48.97
28-dhjetor -23		26.01			41.01

Në tremujorin e katërt të vitit 2023, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë ka rënë në mesatarisht 47.70 miliardë lekë kundrejt shifrës rekord 54.20 miliardë lekë në tremujorin e mëparshëm dhe 44.65 miliardë lekë mesatarisht në gjashtë muajt e parë të vitit 2023. Mungesa ka qenë në nivelet maksimale mbi 60 miliardë lekë gjatë muajit tetor dhe ka filluar një prirje rënëse me

¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti.

fillimin e muajit nëntor. Në fund të muajit dhjetor, mungesa ishte afër 40 miliardë lekë. **Rënia e mungesës ka ardhur paralelisht me rënien e likuiditetit në llogarinë e qeverisë me rreth 23.5 miliardë lekë, ku 13.7 miliardë lekë kanë kontribuar në rënien e mungesës, ndërsa 9.8 miliardë lekë ka qenë efekti i maturimit të marrëveshjeve SWAP.**


Blerja e valutës në tregun valutë me efekt 5.35 miliardë lekë ishte faktori tjetër me efekt pozitiv në rënien e mungesës, i përqëndruar në pjesën e dytë të periudhës për shkak të përdorimit të opsionit forward në ankandet e zhvilluara. Paraja në qarkullim ka pasur ndikim minimal për 500 milionë lekë, por me zhvillim pozitiv krahasuar me sezonalitetin e këtij treguesi. **Në total gjatë vitit 2023, paraja në qarkullim është rritur me një shumë afër 6.8 miliardë lekë kundrejt rreth 23 miliardë lekë në dy vitet e mëparshme.** Veprimet me portofolin kanë pasur veprim minimal në rënien e mungesës me 600 milionë lekë.

Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë, ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor për mesatarisht 59.4% kundrejt 64% - 68% në 9 muajt e parë të vitit.

Në ndryshim nga nëntë muajt e parë të vitit, ku fokusi i operacioneve ka qenë targetimi i një likuiditeti më të lartë në kushtet e përqëndrimit të mungesës në banka me mundësi të kufizuara financimi dhe presionit në normat e kërkuara në injektimet e Bankës së Shqipërisë, duke parë rritjen e ekspertizës së bankave në normat e kuotuar dhe ndikimin negativ të akomodimit në vëllimet e tregëtuara në tregun ndërbankar, **përpjekjet janë drejtuar drejt krijimit të hapësirave për përdorim më të madh të tregut ndërbankar si formë financimi kundrejt financimit në operacionet e Bankës së Shqipërisë.** Ky ndryshim u konsiderua i favorshëm në përgatitjen e bankave për ulje të shumave të injektuara nga Banka e Shqipërisë, duke parë hapësirat e mëdha të MFE për të shpenzuar në ditët e fundit të vitit 2023 dhe javët e para të muajit janar për efekt të buxhetit të vitit 2023.


Si rezultat, u vu re rritje graduale e raportit të mbulimit të ankandëve dhe paralelisht me të, rritje e vëllimeve të tregëtimit për shkak të zhvendosjes së kërkesës në tregun ndërbankar, por edhe të rritjes së presionit për përdorimin e kredisë njëditore. Pavarësisht se është tregëtuar deri në 50 bp mbi normën bazë, norma mesatare e tregëtimit në tregun ndërbankar javor, nuk ka kaluar më shumë se 20 bp mbi nivelin e normës bazë dhe ka qenë mesatarisht 8 bp më e lartë gjatë periudhës.

Krahas rritjes së normës mesatare të tregëtimit në tregun njëjavor, edhe norma e injektiveve javore të Bankës së Shqipërisë, është rritur në mesatarisht 7.8 bp mbi normën bazë, kundrejt 4-5 bp në periudhën prill-shtator kundrejt 13bp në tremujorin e parë të vitit 2023.



Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2023 (me vlerë nominale)
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Marrëveshje e anasjelltë riblerjeje sipas maturimeve në periudhën 2016-2023



1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme


Përdorimi i instrumentit të depozitës është rritur gjatë periudhës në mesatarisht 4.7 miliardë lekë kundrejt vetëm 0.5 miliardë lekë në periudhën e kaluar. Krahasimisht me periudhat e kaluara, numri i bankave që përdorin instrumentin e depozitës si në fund të periudhës të rezervës së detyruar, ashtu dhe në mes të saj, është në rritje.

Kredia është përdorur në 14 raste, 11 raste prej të cilave janë nga Banka Amerikane e Investimit, ndërkohë që në periudhën janar-shtator janë evidentuar 39 raste të përdorimit të kredisë njëditore dhe në të gjithë rastet kjo kredi është përdorur nga Banka Amerikane e Investimit.

1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e Bankës së Shqipërisë

Gjatë 3-mujorit katërt të vitit 2023, Banka e Shqipërisë ka vijuar të tentojë rritjen e portofolit nëpërmjet ankandeve të blerjes së letrave me vlerë. Sikurse përgjatë gjithë vitit 2023, pjesëmarrja e bankave ka qenë mjaft e ulët, duke bërë që në 5 ankande, portfoli të rritet me vetëm 600 milionë lekë dhe të mbetet në vlera pranë nivelit të poshtëm të bandës së miratuar. Hezitimi i pjesëmarrjes për shkak të ecurisë pozitive të titujve të qeverisë dhe riklasifikimi i pjesës më të madhe të portofoleve në HTM gjatë vitit 2022 kanë qenë sërish faktorët e pjesëmarrjes së ulët.

Vlera e portofolit të bonove të thesarit të Bankës së Shqipërisë është 69.65 miliardë lekë, pranë niveleve maksimale të vërejtura, por në terma relativë kundrejt borxhit publik të emetuar në monedhën kombëtare, madhësia e portofolit është nën 10% kundrejt rreth 25% në fillim të viteve 2000.



1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës në fjalë janë zhvilluar operacione rregulluese në fund të RD të periudhës shtator-tetor, në fillim të RD të periudhës nëntor-dhjetor si dhe në ditën e fundit të vitit 2023. Operacionet rregulluese në muajin tetor dhe dhjetor janë kryer për shkak të kërkesave të paparashikuara në injektimet javore nga bankat me tepriçë likuiditeti, ndërsa në muajin nëntor rezultoi një shmangie negative e faktorëve në periudhën e ditëve të njëpasnjëshme të pushimit të festave kombëtare (24-30 nëntor).

Në momentin e realizimit të operacionit injektues të muajit tetor kishim përdorim të kredisë njëditore, në nëntor kishim rritje të normës mesatare të tregut javor me 20 bp mbi normën bazë, ndërsa në muajin dhjetor kishim përdorim të kredisë si dhe rritje të normës së tregut me 10 bp mbi normën bazë. Shumat e injektuara kanë qenë 2.5-5.00 miliardë lekë.

2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË KATËRT TË VITIT 2023

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë 3-mujorit të katërt të vitit 2023, sikurse lajmëruar në 13 dhjetor 2022 dhe rishikuar në datën 3 gusht 2023, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar katër ankande për blerjen e valutës, ku vetëm njëri prej tyre ka qenë me opsionin SPOT.


Në ankandet e zhvilluara janë blerë 66 milionë Euro shifër kjo pothuajse e njëjtë me atë të blerë në tremujorin e mëparshëm në 5 ankande. Efekti në likuiditetin e injektuar gjatë tremujorit ka qenë ai i vetëm 4 ankandëve për 5.35 miliardë lekë pasi ankandi i fundit ishte forward me datë valutë 22 janar 2024. Gjatë vitit 2023, nëpërmjet blerjes së valutës nga ankandet, janë injektuar në sistemin bankar 25.1 miliardë lekë.

Rritja e mëtejshme e shumave të kërkuara nga Banka e Shqipërisë në ankandet e blerjes së valutës (5-10 milionë), ka ndaluar tendencën rritëse të raportit të mbulimit, por mbetet në nivele të mjaftueshme për të pasur ankande konkurruese, mbi 1.5. **Për këtë arsye, në skedulin e vitit 2024 të publikuar në muajin dhjetor ku objektivi i blerjeve është rritur, është mbajtur shumë e njëjtë dhe është rritur numri i ankandëve në 20 kundrejt 17 të zhvilluara në vitin 2023.**

Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2023			
Data	Shuma Raundi I (ne euro)		
1	2/17/2023	5-9 mln	1 mo FW
2	3/17/2023	5-9 mln	1 mo FW
3	4/11/2023	5-9 mln	1 mo FW
4	4/20/2023	5-9 mln	
5	5/11/2023	5-9 mln	
6	5/26/2023	5-9 mln	
7	6/9/2023	5-9 mln	
8	6/21/2023	5-9 mln	1 mo FW
9	7/6/2023	5-9 mln	
10	7/20/2023	5-9 mln	
11	8/4/2023	5-9 mln	
12	8/18/2023	5-9 mln	1 mo FW
13	9/22/2023	5-10 mln	
14	10/18/2023	5-10 mln	1 mo FW
15	11/17/2023	5-10 mln	1 mo FW
16	12/6/2023	5-10 mln	
17	12/20/2023	5-10 mln	1 mo FW

** Ne rastet kur ankandi bie ne dite pushimi, ankandi do te organizohet ne ditën pasardhese te punes.*

Gjatë vitit 2023, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon të blejë përmes ankandeve 160-220 milionë Euro.



**Kalendari i ndërhyrjeve -
Viti 2024**

	Data	Shuma Raundi I (në euro)	
1	16/02/2024	5-10 mln	1 mo FW
2	15/03/2024	5-10 mln	
3	26/03/2024	5-10 mln	1 mo FW
4	19/04/2024	5-10 mln	
5	30/04/2024	5-10 mln	1 mo FW
6	17/05/2024	5-10 mln	
7	24/05/2024	5-10 mln	1 mo FW
8	06/06/2024	5-10 mln	
9	13/06/2024	5-10 mln	1 mo FW
10	21/06/2024	5-10 mln	
11	12/07/2024	5-10 mln	
12	19/07/2024	5-10 mln	
13	26/07/2024	5-10 mln	
14	09/08/2024	5-10 mln	
15	16/08/2024	5-10 mln	1 mo FW
16	17/09/2024	5-10 mln	1 mo FW
17	18/10/2024	5-10 mln	1 mo FW
18	20/11/2024	5-10 mln	1 mo FW
19	05/12/2024	5-10 mln	
20	20/12/2024	5-10 mln	1 mo FW

* Në rastet kur ankandi bie në ditë pushimi, ankandi do të organizohet në ditën pasardhëse të punës.

Gjatë vitit 2024, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon të blejë përmes ankandëve 250-330 milionë Euro.

Pas regjistrimit të nivele të ulëta të njëpasnjëshme, kursi i këmbimit Eur/Lek është stabilizuar gjatë tremujorit në zonë relativisht më të ngushtë të tregëtimit 101.20-106.20 lekë me mesatare tregëtimi rreth nivelit 104.00 lekë. Megjithatë, presionet forcuese mbeten pasi në fund të periudhës niveli 103.30 lekë është afër 2.8% më i ulët se ai i fillimit të tremujorit prej 106.20 lekë. Volatiliteti i lartë i periudhave të fundit, ka bërë që *spreadet* në tregun ndërbankar të stabilizohen në nivele më të larta se historikisht, por pa çenuar ndjeshëm tregëtimin.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023, MFE ka maturuar marrëveshjen SWAP për 85 milionë Euro, duke e cuar në 0. Megjithatë, pritja është për përdorim sërish të këtij opsioni gjatë vitit 2024, pasi MFE ka kërkuar shtimin e shumës së mundshme në 50 miliardë lekë kundrejt 25 miliardë lekë që parashikon marrëveshja bazë midis institucioneve.

Në veprime të tjera, janë blerë 2.1 milionë Euro nga MFE të fondeve të programit IPA.